



Padrejtësi Toksike

Përkthimi i përgjegjesisë së OKB-së në zgjidhje për romët e Kosovës

Klinika Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Fakultetin Juridik të Harvardit dhe Opre Roma Kosovo



Ilustrimi i kopertinës
Refugjatët romë në Kosovë jetojnë në kushte të pasigurta
© Carsten Koall / Getty Images

Dizenjimi
Tutaev Design

Të drejtat e autorit © 2022 Presidenti dhe Bashkëpunëtorët e Kolegjit Harvard

Padrejtësi Toksike:

Përkthimi i përgjegjësisë së OKB-së në zgjidhje
për romët e Kosovës

Klinika Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Fakultetin Juridik
të Harvardit dhe Opre Roma Kosovo

Nëntor 2022

PASQYRA E LËNDËS

FALËNDERIME	2
SHËNIM MBI TERMINOLOGJINË	3
SHKURTESA	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
Përgjegjësia e OKB-së për Helmimin nga Plumbi	5
Mekanizmat Iluzionare të Përgjegjshmërisë së OKB-së	6
Metodologjia	7
Gjetjet kryesore	8
Thirrja për veprim	9
I. PËRGJEGJËSIA E OKB-SË PËR EKSPOZIMIN E ROMËVE NDAJ HELMIMIT ME PLUMB	13
A. Konteksti: Roli i OKB-së në Kosovë	13
B. OKB-ja i strehoi romët e zhvendosur në kampe ku ekspozimi i tyre ndaj plumbit ishte i parashikueshëm	17
C. UNMIK-u shpërfilli paralajmërimet urgjente dhe nuk arriti të ndalonte ekspozimin ndaj plumbit të rrezikshëm	19
D. UNMIK-u nuk mundi t'u siguronte banorëve të kampit analiza të vazhdueshme ose trajtim mjekësor për helmimin nga plumbi	19
II. KOMUNITETET ROMË PËRJETOJNË DËME TË VAZHDUESHME NGA HELMIMI ME PLUMB	21
III. OKB-JA SHMANGU PËRGJEGJËSITË DUKE BLOKUAR QASJEN NË DREJTËSI	24
A. Detyrimet e UNMIK-ut për të Drejtat e Njeriut	24
B. Korniza e Përgjegjshmërisë së OKB-së	25
C. Përpjekjet e viktimave për të aksesuar mjetet juridike efektive	27
IV. OKB-JA KA DËSHTUAR TË PËRMBUSHË REKOMANDIMIN E PKDNJ-SË	33
A. Përgjigja e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të PKDNJ-së	33
B. Përgjigja e Sekretariatit të OKB-së	34
C. Kritikata mbi përgjigjen e OKB-së	35
V. HAPA TË NEVOJSHËM DREJT PËRGJEGJËSISË	37
A. Aspektet thelbësore të mjeteve juridike efektive për helmimin nga plumbi	37
B. OKB-ja mund t'i dëgjojë lehtësisht rekomandimet e PKDNJ-së	38
C. OKB-ja duhet të bashkërendojë procesin e saj të ankesave me standardet ndërkombëtare	39
D. PKDNJ-ja ofron mësim të rëndësishme për OKB-në	40
PËRFUNDIME	43

FALËNDERIME

Ky është një botim i përbashkët i organizatës Opre Roma Kosovo dhe Klinikës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Fakultetin Juridik të Harvardit.

Opre Roma Kosovo është një lëvizje me seli në Kosovë që përfaqëson zërat, miqtë dhe partnerët romë, të cilët punojnë drejt fuqizimit dhe përfshirjes politike, sociale, dhe ekonomike të komuniteteve Rome në Kosovë dhe Diasporë. Themeluar në vitin 2021 si përgjigje ndaj pabarazive të vazhdueshme sociale ndaj popullit Rom, Opre Roma Kosovo organizon anëtarët e komunitetit rreth çështjeve kryesore që lidhen me ta, si: segregimi në shkollë, përpjekjet për census, dhe korrigjimi i dëmeve historike.

Klinika Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (KNDNJ) në Fakultetin Juridik të Harvardit kërkon të mbrojë dhe promovojë të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare përmes dokumentacionit; analizës ligjore, faktike dhe strategjike; proceseve gjyqësore para organeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare; negociatave të traktateve dhe iniciativave të politikave dhe avokimit. KNDNJ-ja angazhohet në edukimin klinik inovativ për të zhvilluar teknika praktike të avancuara dhe qasje për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. KNDNJ-ja ka një histori të gjatë në fushën e avokimit për të drejtën për mjete efektive juridike për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë dëmet mjedisore që vijnë nga industritë nxjerrëse dhe mbetjet toksike të luftës. Instruktorja Klinike e KNDNJ-së Beatrice Lindstrom ka punuar me çështjet e llogaridhënies së OKB-së që nga viti 2010. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të IHRC-së <http://hrp.law.harvard.edu/clinic/>.

Ky raport u shkrua dhe u redaktuar nga studentët e Fakultetit Juridik të Harvardit, Anna Bower, J.D. '23; Joey Bui, J.D. '21; Madison Ferris, J.D.'23; Nathalie Gunasekera, J.D. '21; Erika Holmberg, J.D. '22; Bailey Kennedy, J.D. '22; Tomisin Ogunsanya, J.D.'22; Scarlett Park, J.D. '24; Yinsheng Qu, E.S.Fall '21; dhe Jake Soria, J.D. '24; së bashku me Instruktorin Klinike dhe Lektoren e Drejtësisë Beatrice Lindstrom. Raporti bazohet në hulumtimin e kryer nga Elise Baranouski, J.D. '20; Angela Gichinga, J.D. '21; dhe Saranna Soroka, J.D. '20.

Ky raport bazohet kryesisht në kërkimin sekondar, si dhe nga dokumentacioni i mbledhur nga Opre Roma Kosovo, Human Rights Watch, Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut dhe nga Raportuesi Special për Mbetjet Toksike dhe të Drejtat e Njeriut. Raporti grumbulloi informacione edhe nga bisedat gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit ligjorë mbi viktimat e helmimit me plumb, ekspertët ligjorë të OKB-së, ekspertët e shëndetit publik dhe avokatët e komunitetit rom,.

Autorët shprehin mirënjohjen për Katharina Rall, Dianne Post, Bonnie Docherty dhe Margareta Matache për kontributin dhe komentet e bëra për draftet. Për më tepër, autorët dëshirojnë.

SHËNIM MBI TERMINOLOGJINË

Ky raport përdor ‘Romët’ si një term ombrellë për të përfshirë Romët, ashkallitë dhe egjiptianët në Kosovë. Kjo përputhet me qasjet e miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe institucionet e tjera ndërkombëtare dhe evropiane, duke përfshirë Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Evropës, për të unifikuar dhe forcuar barazinë për komunitetet Rome.¹ Kjo terminologji është gjithashtu në përputhje me misionin e Opre Roma në Kosovë për të forcuar fuqinë të komuniteteve më të gjera Rome në mbarë Kosovën për të marrë pjesë në jetën publike dhe politike në Kosovë. Ne e pranojmë se ka këndvështrime të ndryshme për mënyrën më gjithëpërfshirëse për t’iu referuar popullit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, të cilët ndajnë të përbashkëta dhe dallime komplekse. Duke zgjedhur përputhshmërinë me qasjet ndërkombëtare, ne nuk synojmë të përjashtojmë ata që vetë-identifikohen si ashkali dhe egjiptianë.

1 Shih p.sh., Kombet e Bashkuara, Roli i Kombeve të Bashkuara në avancimin e përfshirjes së Romëve, shkurt 2013. <https://europe.ohchr.org/Documents/Publications/RomaInclusion.pdf> (“termi “Rom” përdoret për t’iu referuar një numri i grupeve të ndryshme (Romë, Sinti, Ciganë, Kale, Romanichels, Beash, Ashkali, Egjiptianë, Yenish, Udhëtarë, Dom, Lom dhe të tjerë) të identifikuar si në rrezik të diskriminimit ose përjashtimit social. Qasjet e OKB-së në këtë fushë janë të harmonizuara gjerësisht me ato të institucioneve të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian, OSBE-në dhe të tjerë”); Komisioni Evropian, “Barazia, përfshirja dhe pjesëmarrja e romëve në BE”, https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/roma-eu/roma-equality-inclusion-and-participation-eu_en#:~:text=The%20umbrella%2Dterm%20'Roma',discussions%20commonly%20employ%20this%20terminology (“Termi ombrellë ‘Rom’ përfshin grupe të ndryshme, duke përfshirë romët... ashkali, egjiptianë...); C Fjalori përshkrues i termave të Këshillit të Evropës në lidhje me çështjet e Romës, 18 maj 2012, <http://a.cs.coe.int/team20cahrom/documents/Glossary%20Roma%20EN%20version%2018%20May%202012.pdf> (duke shpjeguar se termi “Rom” u miratua për përdorim pas shqyrtimit të gjerë të historisë dhe konsultimeve me nëngrupe të ndryshme, dhe pasqyron një pikëpamje konsensusi në të gjithë Këshillin).

SHKURTESA

KPIKB	1946 Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara
BE	Bashkimi Evropian
PKDNJ	Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut
HRW	Human Rights Watch
PZHBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
KFOR	Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (e njohur kryesisht si Forca e Kosovës)
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (e njohur edhe si Aleanca e Atlantikut të Veriut)
ZÇL	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ligjore
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SHNJK	Shoqëria për Njerëzit e Kërcënuar
KB	Kombet e Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2016, një organ ligjor i krijuar nga Kombet e Bashkuara (OKB) për të vlerësuar përgjegjësinë e vetë OKB-së për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë, publikoi një opinion me vlerë historike. Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ) e cilësoi Misionin e UNMIK-ut në Kosovë (UNMIK) përgjegjës për ekspozimin e romëve ndaj helmimit me plumb në kampet e zhvendosjes dhe e udhëzoi organizatën që t'u sigurojë viktimave mjete juridike, duke përfshirë kompensimin financiar.¹ Megjithatë, pasi kanë kaluar gjashtë vjet nga marrja e vendimit - dhe mbi 20 vjet që kur OKB-ja i vendosi për herë të parë të zhvendosurit në kampe të kontaminuara me plumb - OKB-ja nuk ka mundur të zbatojë rekomandimet e Panelit të saj ose të sigurojë dëmshpërblim për viktimat². Ky raport ofron shqyrtimin e parë gjithëpërfshirës të mënyrave se si OKB-ja ka manovruar proceset ligjore për të shmangur marrjen e përgjegjësisë për shkeljet e saj ligjore në Kosovë. Vendimi i PKDNJ-së ishte rezultat i një beteje ligjore dhjetëvjeçare gjatë të cilës OKB-ja i dërgoi viktimat të kërkonin në tym nëpër mekanizmat e saj të brendshëm të llogaridhënies³. Pasi krijoi iluzionin e një procesi gjyqësor që mund të siguronte drejtësi, OKB-ja më pas shpërfilli gjetjet e PKDNJ-së, duke i lënë viktimat në dhimbjen e tyre pa u ofruar ndihmë apo mundësi për ta siguruar këtë lloj ndihme. Kjo përvojë nxjerr në pah mangësi të mëdha në sistemin e llogaridhënies së OKB-së të cilat duhet të adresohen në mënyrë që organizata të ruajë pozitën e saj morale si mbrojtëse e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Përgjegjësia e OKB-së për Helmimin nga Plumbi

Nga viti 1999 deri në vitin 2008, UNMIK-u shërbeu si qeveri *de facto* në Kosovë, me një mandat të gjerë që përfshinte mbrojtjen e të drejtave të njeriut⁴. Pas luftës së Kosovës në vitin 1999, rreth 8,000 romë u detyruan të braktisin shtëpitë e tyre në veri të Kosovës pasi lagjja e tyre, e njohur si Mëhalla e Romëve, u sulmua dhe u shkatërrua.⁵ UNMIK-u strehoi rreth 600 nga romë të zhvendosur në disa kampe zhvendosjeje në një zonë që njihet gjerësisht si e kontaminuar me plumb.⁶ Kampet kishin për qëllim të ofronin strehim të përkohshëm për 45 deri në 90 ditë, por mbetën të hapura për më shumë se një dekadë, pavarësisht paralajmërimeve të përsëritura se zona ishte e papërshtatshme për banim dhe paraqiste një emergjencë të rrezikshme për jetën që kërkonte evakuim të menjëhershëm.⁷ Gjatë kësaj kohe, PZHBV-të jetuan në kushte të mjerueshme që me shumë mundësi favorizuan ekspozimin e tyre ndaj plumbit dhe përkeqësuan efektet e helmimit me plumb. OKB-ja gjithashtu nuk arriti t'u sigurojë PZHBV-ve akses të vazhdueshëm në bërjen e analizave të gjakut çka është thelbësore për diagnostikimin e helmimit me plumb; nuk mundi t'i informonte ata në mënyrën e duhur për rreziqet e mëdha shëndetësore që ata kanë shkaktuar; ose nuk arriti t'u siguronte akses në trajtim mjekësor gjithëpërfshirës për helmimin me plumb dhe efektet e tij.

Si rezultat, romët që banonin në kampe përjetuan nivele ekstreme të helmimit nga plumbi, të cilat u manifestuan si dëmtime të pakthyeshme për shëndetin e tyre.⁸ Sipas Qendrave të SHBA-së për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (KPS), pothuajse të gjithë fëmijët që u rritën në kampe kishin nivele të rrezikshme plumbi në gjak në një moment të caktuar gjatë fëmijërisë së tyre.⁹ Shumë prej tyre përjetuan probleme të rënda shëndetësore dhe



Fëmijë duke vrapuar në kampin në Cesminluke/Česmin Lug. Të drejtat e autorit: Darren McColleston.

paaftësi zhvillimore që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite¹⁰. Helmimi me plumb në nivele të larta mund të jetë fatal, dhe shumë fëmijë dhe të rritur vdiqën në kampe ku hidhet dyshimi se vdiqën nga helmimi me plumb, megjithëse numri i saktë nuk dihet.¹¹

Që nga mbyllja e kampit të fundit në vitin 2013, grupet e të drejtave të njeriut kanë dokumentuar probleme shëndetësore të vazhdueshme mes ish-banorëve të kampit që lidhen me ekspozimin ndaj plumbit për një kohë të gjatë, duke përfshirë konvulsione, humbje të kujtesës, probleme me zemrën dhe veshkat.¹² Kjo gjendje dhe sistemet e dobësuara imunitare që shpesh vijnë si rezultat i helmimit me plumb, tashmë e bëjnë komunitetin e prekur veçanërisht të cenueshëm ndaj COVID-19.¹³ Nevoja për mjete juridike efektive për viktimat mbetet urgjente.

Mekanizmat Iluzionare të Përgjegjshmërisë së OKB-së

Ky raport shqyrton proceset, rregullat dhe veprimet ligjore të OKB-së që i mundësuan asaj t'i shmangej përgjegjësisë për helmimin me plumb në Kosovë. OKB-ja ka detyrime ligjore të mirë përcaktuara për të ofruar kompensim për civilët e lënduar nga neglizhenca e saj, por gjithashtu gëzon imunitet të gjerë çka i pengon gjykatat të shqyrtojnë paditë e ngritura kundër

saj. Si rezultat, individët e lënduar nga OKB-ja detyrohen të mbështeten në mekanizmat e vetë organizatës për mjetet korrigjuese. Në përgjithësi, e vetmja rrugë për të korrigjuar është të kërkojë kompensim nga Zyra e OKB-së për Çështjet Ligjore (ZÇL) në Nju Jork,¹⁴ e cila merr vendime për përgjegjësinë e saj nëpërmjet një procesi të paqartë dhe diskrecional për sa i përket ankesave. Në njohje të rolit të saj unik në Kosovë, OKB-ja gjithashtu themeloi PKDNJ-në, një organ quasi-gjyqësor dhe i pavarur që gëzon mandat për të vendosur për çështjet që lidhen me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u.¹⁵ PKDNJ-ja prezantoi një mundësi historike për të mundësuar gjykimin e paanshëm të përgjegjësisë së OKB-së dhe për të siguruar që viktimat e dëmeve të shkaktuara nga OKB-ja të kenë akses në mjete juridike.

Megjithatë, kur ish-banorët e kampit kërkuan të përfitonin nga këto procese, OKB-ja i futi në grackën e një procesi ligjor dhjetëvjeçar duke i dërguar ata herë të ZÇL-ja në Nju Jork herë te PKDNJ-ja në Prishtinë, Kosovë.¹⁶ Pas një procesi gjyqësor tetëvjeçar më në fund u arrit fitorja për viktimat romë, megjithatë OKB-ja i shpërfilli gjetjet e PKDNJ-së dhe akoma nuk ka zbatuar qoftë edhe një rekomandim të vetëm që synon ofrimin e mjeteve juridike të vonuara për lëndimet e shkaktuara në kampe.¹⁷

“Është e jashtëzakonshme që pavarësisht dëmeve, shkakësive, dhe keqdashjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara ende nuk ka bërë ecuri kuptimplotë drejt ndihmës për komunitetin e prekur.”

- Baskut Tuncak, Raportues Special për Substancat Toksike dhe të Drejtat e Njeriut (2020)

Metodologjia

Ky raport shqyrton betejën e zgjeruar ligjore të romëve në kërkim të drejtësisë nga OKB-ja dhe vlerëson gjendjen aktuale të mjeteve juridike për komunitetin e prekur që nga vendimi i PKDNJ-së në vitin 2016. Raporti mbështetet në kërkime sekondare dhe intervista të zhvilluara me përkrahësit e të drejtave të njeriut, avokatë, ekspertë mjekësorë dhe aktivistë që kanë punuar me komunitetin e prekur. Raporti bazohet në gjetjen e fakteve të mbledhura gjatë dy dekadave të fundit nga Opre Roma Kosovo, Raportuesi Special i OKB-së për Lëndët Toksike dhe të Drejtat e Njeriut, Human Rights Watch dhe aktivistët e komunitetit. Së fundi, raporti mbështetet ndjeshëm në dokumentacionin dhe provat e referuara në opinionin e PKDNJ-së të vitit 2016.

Raporti është hartuar në katër pjesë. Seksioni I përcakton rolin e OKB-së në ekspozimin e PZHBV-ve romë ndaj plumbit toksik, duke pasqyruar faktet kryesore të disponueshme në raportet publike dhe opinionet ligjore. Seksioni II përmbledh lëndimet e vazhdueshme të ish-PZHBV-ve të shkaktuara nga helmimi me plumb, të cilat janë dokumentuar nga Opre Roma Kosovo dhe nga hetimet më të fundit të grupeve të tjera të të drejtave të njeriut

gjatë viteve të fundit. Seksioni III përshkruan përpjekjet ligjore të viktimave në kërkim të drejtësisë, ku detajohen manovrat e stërzgjatura të OKB-së për t'iu shmangur përgjegjësisë. Seksioni IV raporton moszbatimin e rekomandimeve të propozuara nga PKDNJ-ja nga ana e OKB-së dhe nevojën e vazhdueshme dhe urgjente për mjete juridike. Së fundi, Seksioni V përshkruan hapat që OKB-ja dhe aktorët e tjerë duhet të ndërmarrin aktualisht për të përmbushur detyrën e tyre ndaj viktimave dhe për të forcuar llogaridhënien në të ardhmen.

Gjetjet kryesore

Më poshtë, paraqiten gjetjet kryesore të raportit:

1. OKB-ja manovroi mekanizmat e saj të llogaridhënies për të mohuar dëmshpërblimin ndaj viktimave të helmimit me plumb

Një grup ish-banorësh të kampit rom i paraqitën fillimisht ankesat përmes procesit të pretendimeve të palës së tretë të ZÇL-së në Nju Jork në vitin 2006, me anë të të cilave kërkonin kompensim për dëmtimet e tyre.¹⁸ Për pesë vjet, ZÇL nuk ka ndërmarrë veprime në lidhje me ankesat, duke përmendur kompleksitetin e çështjes.¹⁹ Kur kërkuesit e sollën çështjen e tyre në PKDNJ në vitin 2008, UNMIK-u u përpoq që çështja të mos dëgjohej nga organi i pavarur, duke argumentuar se kërkuesit nuk kishin shteruar hapësira të tjera, duke qenë se ankesa të tjera kishin mbetur pezull pranë ZÇL-së.²⁰

Pasi PKDNJ-ja nuk ra dakord dhe konsideroi çështjen të pranueshme, UNMIK-u hodhi hapin e jashtëzakonshëm të ndryshimit të rregullave të PKDNJ-së për ta zhveshur nga çdo juridiksion që mund të përfshihej në kompetencën e ZÇL-së.²¹ UNMIK-u i zbatoi rregullat e reja në mënyrë retroaktive, duke e detyruar PKDNJ-në që të rishikonte të gjitha vendimet e pranueshmërisë dhe të pushonte çështjen. UNMIK-u gjithashtu vendosi një afat të ri për depozitimin e çështjeve me PKDNJ-në, duke e ndaluar Panelin nga marrja e çështjeve të depozituara pas 31 marsit, 2010.²² Më pas, në qershor 2011, ZÇL-ja e pushoi çështjen kolektivisht, duke e konsideruar “të patrajtueshme”.²³ Duke pritur sa të kalonte afati i marsit 2010 për të hedhur poshtë ankesat, veprimet e OKB-së do të kishin mbyllur të vetmen hapësirë të disponueshme për të kërkuara korrigjim.

Duke pranuar se ky manovrim do të “fyente nocionet bazë të drejtësisë”, PKDNJ-ja vendosi ta rihapte çështjen në vitin 2012 pas kundërshtimeve të UNMIK-ut.²⁴ Në shkurt 2016, pas një procesi të fuqishëm ligjor dhe shqyrtimit të provave të gjera, PKDNJ-ja dha vendimin në favor të kërkuesve.²⁵ Paneli e shpalli UNMIK-un përgjegjës për shkeljen e një sërë të drejtave të njeriut dhe rekomandoi që OKB-ja të kërkojë falje publike dhe t’u paguajë kompensimin adekuat kërkuesve.²⁶

2. OKB-ja ka shpërfillur rekomandimet e PKDNJ-së, duke shkelur sërish të drejtat e viktimave për një mjet efektiv juridik.

Menjëherë pasi PKDNJ-ja nxori vendimin e tij, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së António Guterres mori detyrën. Në fjalën e tij drejtuar Asamblesë së Përgjithshme për dhënien e

betimit, ai theksoi nevojën e OKB-së për të “siguruar transparencë dhe llogaridhënie dhe për të ofruar mbrojtje dhe mjete juridike efektive për viktimat” e dhunës seksuale dhe shfrytëzimit të kryer nën flamurin e OKB-së, duke sinjalizuar një angazhim të fortë ndaj parimit të llogaridhënies.²⁷ Por nën drejtimin e Guterres, OKB-ja deri më tani ka dështuar në zbatimin e rekomandimeve nga PKDNJ-ja, duke i lënë viktimat romë pa kompensim. Në vend të një faljeje publike, Guterres shprehu keqardhjen për vuajtjet e banorëve të kampit, por nuk e pranoi përgjegjësinë e OKB-së.²⁸ Ndërsa Guterres krijoi një fond besimi për projektet komunitare në përfitim të romëve, të Mitrovicës së Veriut dhe Mitrovicës së Jugut/ Mitrovicës, OKB-ja nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të adresuar dëmet konkrete dhe të vazhdueshme që pësojnë banorët e kampit.²⁹ Për më tepër, OKB-ja ka siguruar vetëm një kontribut prej 10,000 dollarësh në fondin e besimit,³⁰ dhe fondi tani duket inekzistent.

3. Zbatimi i rekomandimeve të PKDNJ-së dhe ofrimi i një zgjidhjeje efektive për komunitetin e prekur është urgjente dhe e realizueshme

Hetimet e kryera nga organizatat e të drejtave të njeriut dhe aktivistët romë që nga vendimi i PKDNJ-së në vitin 2016 kanë dokumentuar vazhdimësinë e problemeve shëndetësore dhe aftësive të kufizuara zhvillimore të romëve që jetonin në kampe.³¹ Gjatë hartimit të këtij raporti, ata vazhdonin të luftonin për të aksesuar kujdesin e duhur shëndetësor dhe testimin e rregullt të plumbit në gjak. Pandemia e COVID-19 vetëm sa e ka rritur nevojën për të ofruar mjete juridike efektive. Ndërkohë, OKB-ja mund t’i respektonte lehtësisht rekomandimet e PKDNJ-së dhe të siguronte kompensim për viktimat. Faktorë të ndryshëm të lidhur konkretisht me këtë çështje i bëjnë mjetet korigjuese të realizueshme, duke përfshirë numrin relativisht të vogël të viktimave, disponueshmërinë e dokumentacionit të gjerë të lëndimeve të tyre dhe faktin që përgjegjësia e OKB-së tashmë është përcaktuar. Barriera kryesore ndaj drejtësisë është mungesa e vullnetit politik.

4. Përvoja e viktimave të helmimit nga plumbi zbulon probleme më të gjera strukturore me sistemin e llogaridhënies së OKB-së që duhet të reformohet

Beteja e stërzgatur e viktimave romë për drejtësi zbulon të meta të thella në kuadrin e llogaridhënies së OKB-së, me pasoja të gjera përtej rastit të helmimit me plumb. Pas përfundimit të mandatit të tyre në vitin 2016, panelistët që punuan me PKDNJ-së përqeshën mosveprimin e vazhdueshëm të UNMIK-ut dhe refuzimin për të ndjekur rekomandimet e PKDNJ-së, duke e konsideruar procesin një “mashtim” dhe “dështim të plotë.”³² Për më tepër, sistemi i pretendimeve të palëve të treta nuk ka transparencë dhe i mungojnë garancitë themelore procedurale për të siguruar shqyrtimin e drejtë të ankesave. Trajtimi i ankesave nga ZÇL-ja vë në pikëpyetje faktin nëse vetë avokatët e OKB-së mund të veprojnë si arbitra të pavarur të detyrimeve të organizatës në mënyrë që të jenë në përputhje me procesin e duhur. Ai gjithashtu thekson nevojën për një organ të pavarur që mund të sigurojë gjykim transparent, të paanshëm dhe të drejtë për ankesat e individëve. Krijimi i PKDNJ-së ishte një pilotim i rëndësishëm për këtë mekanizëm. Megjithatë, shpërfillja përfundimtare e OKB-së për gjetjet e organit të saj, nënvizon nevojën që mekanizma të tillë të fuqizohen për të nxjerrë vendime detyruese. Nëse këto boshllëqe nuk adresohen, viktimat e neglizhencës së OKB-së nuk kanë gjasa të kenë akses në drejtësi.

Thirrja për veprim

Siç ka vërejtur Raportuesi Special i OKB-së për Lëndët Toksike dhe të Drejtat e Njeriut në vitin 2020, të drejtat e komuniteteve rom janë shkelur në mënyrë të padiskutueshme në kampet e menaxhuara nga UNMIK-u.³³ Por “shkelja më tinëzare dhe e vazhdueshme” është se komuniteti vazhdon të vuajë “mizorinë torturuese të një premtimi iluzionar për një të ardhme më të ndritur, i cili është prishur herë pas here nga faljet legaliste, një fond besimi pa qëllim dhe pa shpresë, dhe heshtje nga komuniteti ndërkombëtar”.³⁴ Ky raport vepron si një thirrje urgjente për OKB-në dhe shtetet e saj anëtare që të ndjekin rekomandimet e PKDNJ-së. OKB-ja prej kohësh duhet t’u kishte kërkuar falje publike ish-banorëve të kampit rom, ajo duhet të sigurojë kompensim për lëndimet e tyre, të dëgjojë dhe të veprojë sipas ankesave të familjeve të prekura dhe të reformojë mekanizmat e llogaridhënies së OKB-së për të parandaluar përsëritjen e veprimeve të saj në Kosovë.

Në mënyrë të veçantë, ne kërkojmë që rekomandimet e mëposhtme të zbatohen pa vonesa të mëtejshme:

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Si drejtues i OKB-së, roli i të cilit përfshin ruajtjen e vlerave dhe autoritetit moral të organizatës, Sekretari i Përgjithshëm duhet:

1. Të pranojë publikisht përgjegjësinë e OKB-së dhe t’u kërkojë falje viktimave të helmimit me plumb të komunitetit rom.
2. Të angazhohet për t’u ofruar kompensim viktimave të helmimit me plumb.
3. Të sigurojë financimin e duhur të kompensimit duke kërkuar që Shtetet Anëtare ta financojnë atë nëpërmjet kontributeve individuale ose vlerësimeve të detyrueshme.
4. Të kryejë një rishikim gjithëpërfshirës të kornizës së përgjegjësisë së OKB-së për korrigjimin e dëmeve civile, duke përfshirë shqyrtimin e reformave të mëposhtme:
 - a. Të punojë me ZÇL-në për të rritur transparencën dhe efikasitetin në procesin e pretendimeve të palëve të treta duke komunikuar qartësisht dhe publikisht ankesat dhe standardet për pranueshmërinë dhe rregullat e tjera procedurale.
 - b. Të fuqizojë organet e pavarura gjyqësore si komisionet e ankesave për të dëgjuar ankesat e bëra për dëmet e OKB-së dhe për të nxjerrë vendime ligjërish të detyrueshme.

UNMIK

Si subjekt i procedurave të PKDNJ-së dhe palës së adresuar drejtpërdrejt në rekomandime, UNMIK-u duhet:

1. Të sigurojë kompensimin e duhur për viktimat dhe familjet e tyre.
2. Të angazhohet në konsultime kuptimplote me komunitetet e prekura rreth përmbajtjes së mjeteve korrigjuese.

3. Të raportojë mbi progresin a arritur në zbatimin e rekomandimeve të PKDNJ-së në brifingjet tremujore të PSSP-së për situatën në Kosovë.

ZYRA E ÇËSHTJEVE LIGJORE

ZÇL-ja luan rol kyç për të siguruar që përgjigjet e OKB-së ndaj dëmeve që ka shkaktuar të përmbushin standardet bazë të një procesi të rregullt ligjor dhe të jenë në përputhje me kuadrin ligjor të OKB-së dhe parimet e Kartës së OKB-së, duke përfshirë promovimin e të drejtave të njeriut. Ne i bëjmë thirrje ZÇL-së, dhe Këshillit Ligjor të OKB-së në veçanti, të ushtrojnë autoritet për sa vijon:

1. Të rrisin transparencën dhe efikasitetin në procesin e pretendimeve të palëve të treta duke komunikuar qartësisht dhe publikisht ankesat dhe standardet për pranueshmërinë dhe rregullat e tjera procedurale.
2. Të punojnë me pjesë të tjera të sistemit të OKB-së për të garantuar që organizata të korrigojnë dëmet për të cilat është përgjegjëse në një mënyrë që të jenë përputhje me ligjin për të drejtat e njeriut, duke përfshirë kërkimin e plotë të faljes dhe sigurimin e kompensimit të duhur.

VENDET ANËTARE TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Sipas kuadrit të përgjegjësisë së OKB-së, vendet anëtare të OKB-së janë bashkërisht përgjegjës për sigurimin e mjeteve juridike për dëmet nga OKB-ja. Për më tepër, të gjitha shtetet anëtare kanë interes në ruajtjen e legjitimitetit të OKB-së. Si të tilla, shtetet anëtare të OKB-së duhet:

1. T'i bëjnë thirrje Sekretariatit të OKB-së dhe UNMIK-ut që të zbatojnë menjëherë rekomandimet e PKDNJ-së për të mbrojtur legjitimitetin e OKB-së;
2. Të kontribuojnë në financimin e kompensimit për viktimat rome përmes fondit të besimit të OKB-së ose përpjekjeve të tjera shumëpalëshe;
3. Të advokojnë që viktimat rome të konsultohen në hartimin e mjeteve juridike;
4. Të mbështesin rishikimin gjithëpërfshirës të kornizës së OKB-së për korrigjimin e dëmeve civile që i atribuohen OKB-së me synimin për rritjen e transparencës, paanshmërisë dhe rezultateve të drejta.

KËSHILLI I SIGURIMIT

Si organ mbikëqyrës i UNMIK-ut, Këshilli i Sigurimit i OKB-së duhet:

1. Të ftojë Sekretarin e Përgjithshëm dhe PSSP-në që të zbatojnë rekomandimet e PKDNJ-së, veçanërisht në lidhje me kompensimin e viktimave rome për helmim nga plumbi, pa vonesa të mëtejshme.
2. Të kërkojnë raporte mbi progresin e UNMIK-ut në zbatimin e rekomandimeve të PKDNJ-së në informimet e PSSP-së për situatën në Kosovë.

Mitrovicë/Mitrovica Displacement Camps



200 m

I. PËRGJEGJËSIA E OKB-së PËR EKSPOZIMIN E KOMUNITETEVE NDAJ HELMIMIT ME PLUMB

Përgjegjësia e OKB-së për shkeljen e të drejtave të romëve që pësuan helmim me plumb në kampet e menaxhuara nga OKB-ja është analizuar mirë nga monitoruesit e OKB-së për të drejtat e njeriut, organizatat e pavarura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe grupet e të drejtave të romëve kanë dokumentuar dështimet e OKB-së që rezultuan në dëmtimin e komuniteteve të zhvendosura³⁵. Përgjegjësia e OKB-së për ato dëme u gjykua dhe u përcaktua gjithashtu nga PKDNJ-ja në N.M. kundër UNMIK-ut.³⁶ Ky seksion tregon gjetjet kryesore nga ato hetime dhe vendimin e PKDNJ-së të vitit 2016.

A. Konteksti: Roli i OKB-së në Kosovë

Nga viti 1999 deri në pavarësinë e Kosovës në vitin 2008, OKB-ja shërbeu si qeveri *de facto* në Kosovë. Pas sulmet ajrore të NATO-s, të cilat i dhanë fund luftës në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së krijoi dhe dërgoi një prani ndërkombëtare civile dhe të sigurisë për të mbikëqyrur kalimin e pushtetit te vetëqeverisja demokratike dhe për të siguruar një jetë të qetë dhe normale për popullin e Kosovës.³⁷ Ndërkohë që Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) ishte përgjegjëse për sigurimin e “sigurisë dhe rendit publik”³⁸ dhe “krijimin e një mjedisi të sigurt që ofronte kthimin e sigurt në shtëpi të refugjatëve dhe personave të zhvendosur”,³⁹ UNMIK-u mori rolin e administratës së përkohshme. Këshilli i Sigurimit i OKB-së i dha UNMIK-ut kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive,⁴⁰ dhe një mandat në shkallë të gjerë që përfshinte “mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut”⁴¹ dhe “sigurimin e kthimit të sigurt dhe pa pengesa të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë”.⁴² UNMIK-u gjithashtu u zotua se do t’i ushtronte kompetencat e tij në Kosovë në përputhje me standardet dhe parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.⁴³

Për të kryer mandatin e tij të gjerë civil, UNMIK-u u organizua në katër komponentë kryesorë: (1) një administratë civile e udhëhequr nga OKB-ja; (2) një komponent i ndihmës humanitare i udhëhequr nga UNHCR-ja (i cili u mbyll gradualisht në qershor të vitit 2000); (3) një komponent për ndërtimin e institucioneve i udhëhequr nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); dhe (4) një komponent zhvillimi dhe rindërtimi i udhëhequr nga BE-ja.⁴⁴ Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) është kreu i UNMIK-ut dhe kishte “autoritet të plotë” mbi secilin nga komponentët e UNMIK-ut.⁴⁵ Komponentët specifikë vepronin si agjentë të UNMIK-ut, duke e bërë UNMIK-un ligjërishit përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij.⁴⁶

B. OKB-ja i strehoi romët e zhvendosur në kampe ku ekspozimi i tyre ndaj plumbit ishte i parashikueshëm

Pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, mbizotëruan tensionet etnike midis shqiptarëve



Kampi Cesminluke/Česmin Lug me skoriet toksike Trepča në sfond. Të drejtat e autorit: Darren McCollester.

dhe serbëve në vend. Mes dy zjarreve ishin komunitetet rome. Populli rom është një ndër grupet më të marginalizuara në Evropë dhe kanë vuajtur prej kohësh nga diskriminimi dhe persekutimi.⁴⁷ Në qershor të vitit 1999, shqiptarët etnikë, të cilët i shihnin romët si “bashkëpunëtorë të serbëve”, sulmuan dhe shkatërruan lagjen historike të quajtur “Mëhalla e Romëve”, ku banonin 8,000 romë.⁴⁸ Shumë prej banorëve ikën në vendet fqinje, ndërsa rreth 600-700 njerëz kërkuan strehim në kampet e UNHCR-së në veri të Kosovës.⁴⁹

Nga shtatori i vitit 1999 deri në janar të vitit 2000, UNHCR-ja hapi kampe të improvizuara në Cesminluke dhe Zhikoc në veri të Mitrovicës dhe zhvendosi rreth 200 njerëz nga ndërtesat publike në këto dy kampe të reja.⁵⁰ Një pjesë tjetër e romëve të zhvendosur në mënyrë spontane zaptuan kazermat e braktisura të ushtrisë në Kablarë, pranë Cesminlukës dhe Leposaviçit që ndodhen 45 kilometra në veri të Mitrovicës.⁵¹ UNHCR-ja i menaxhoi kampet deri në vitin 2001, kur përgjegjësinë për to e mori UNMIK-u.⁵² Nga viti 2001 deri në vitin 2008, UNMIK-u mbikëqyri administrimin e kampeve dhe ofroi “ndihmë teknike dhe praktike” për banorët e kampit.⁵³

Ishte më se e parashikueshme që distanca e afërt që ekzistonte mes kampeve të Cesminlukës, Zhikocit dhe Kablarës dhe minierës së shkrirjes së plumbit në Trepçë do t'i ekspozonte banorët ndaj niveleve të rrezikshme të plumbit, çka mund të rezultonte në dëme shëndetësore të pakthyeshme.⁵⁴ Plumbi është një metal helmues që hyn në trup përmes ajrit, tokës dhe ujit të kontaminuar. Asnjë nivel i ekspozimit ndaj plumbit nuk konsiderohet i sigurt, por ekspozimi në nivele të larta për një kohë të gjatë është veçanërisht i rrezikshëm, duke shkaktuar probleme shëndetësore të rënda dhe të pakthyeshme, duke përfshirë sëmundjet e zemrës, presionin e lartë të gjakut, mosfunksionimin e veshkave dhe vështirësi me kujtesën dhe përqendrimin.⁵⁵ Ekspozimi ndaj plumbit gjatë shtatzënisë mund të rezultojë në humbje të fëmijës gjatë shtatzënisë/lindjes ose në abort, dhe mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e trurit të fetusit, gjë që mund të çojë në paaftësi intelektuale.⁵⁶ Fëmijët e thithin plumbin më lehtë sesa të rriturit dhe janë veçanërisht të cenueshëm ndaj helmimit nga plumbi.⁵⁷ Fëmijët mund të pësojnë dëme të përhershme në tru, në sistemin nervor qendror, në zhvillimin fizik dhe atë mendor, të cilat rezultojnë në arritje jo të kënaqshme në shkollë, shtim të nervozizmit dhe sjellje antisociale.⁵⁸ Në raste shumë të rënda, helmimi me plumb çon në koma, konvulsione dhe vdekje.⁵⁹

Kampet e Cesminlukës, Zhikocit dhe Kablarës ishin vendosur në afërsi të landfilleve të kontaminuara me plumb të kompleksit mineral të Trepçës, një nga minierat më të mëdha të shkrirjes së plumbit në Evropë.⁶⁰ Miniera e shkrirjes së plumbit në Trepçë ishte një burim famëkeq që shkaktonte ndotjen me plumb, siç është dokumentuar dhe nga studimet shkencore të kryera që nga vitet 1970.⁶¹ Në fakt, PSSP-ja ka pranuar se ishte një fakt më se i njohur që para se të ngriheshin kampet se miniera e shkrirjes së plumbit në Trepçë kishte “çliruar tonelata plumb çdo ditë në atmosferë” duke patur një ndikim negativ në shëndetin e komuniteteve që jetonin aty pranë.⁶²

Fillimisht UNHCR-ja i krijoi kampet si masë e përkohshme me qëllim që të funksiononin për vetëm 45 deri në 90 ditë,⁶³ por në fakt ato funksionuan për më shumë se një dekadë, duke

i bërë banorët subjekt të ekspozimit afatgjatë me plumb.⁶⁴ Gjatë gjithë kësaj kohe, kushtet e jetesës në kampe ishin të mjerueshme, gjë që me shumë mundësi rriti ekspozimin ndaj plumbit dhe përkeqësoi efektet negative shëndetësore të banorëve.⁶⁵ Banorët jetonin në kasolle të improvizuara në mungesë të ujit të rrjedhshëm ose ambienteve të përshtatshme sanitare të cilat nevojiteshin për të minimizuar ekspozimin ndaj plumbit.⁶⁶ Në disa prej kampeve, dyshemetë e ndotura i ekspozuan banorët drejtpërdrejt me tokë të kontaminuar me plumb.⁶⁷ Për më tepër, banorët zakonisht ndiqnin një dietë të varfër ushqimore, çka mund të ketë favorizuar thithjen e plumbit në trup.⁶⁸ Në përgjithësi, kushtet e vështira të jetesës besohet se kanë shkaktuar dobësim të sistemit imunitar mes banorëve, gjë që i bëri ata më të ndjeshëm ndaj ndikimeve negative të plumbit.⁶⁹

Me kalimin e viteve, ekspozimi toksik rezultoi në helmim ekstrem me plumb për shumë prej banorëve. Analizat e pavarura të gjakut dhe flokëve të banorëve zbuluan disa nga nivelet më të larta të plumbit të regjistruara ndonjëherë te njerëzit.⁷⁰ Në mënyrë të veçantë ishin prekur fëmijët. Një vlerësim i bërë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve (QKS) në vitin 2007 zbuloi se shumica e fëmijëve, për të mos thënë



Kushtet e kampit në Cesminluge/Česmin Lug. Të drejtat e autorit: Darren McCollester.

të gjithë, që jetonin në Cesminluke dhe Zhikoc kishin nivele të larta të plumbit në gjak në një moment të caktuar të fëmijërisë së tyre, duke i rrezikuar ata të mos zhvillohen fizikisht dhe të kenë çrregullime të sjelljes dhe gjendje të tjera shëndetësore.⁷¹ Analizat e kryera te fëmijët ndërmjet viteve 2004-2008 kanë rikthyer vazhdimisht nivelet e plumbit në gjak duke tejkaluar nivelin më të lartë që mund të regjistronte aparatura.⁷² Sëmundjet dhe aftësitë e kufizuara në përputhje me helmimin nga plumbi janë të përhapura në mesin e banorëve dhe kanë rezultuar në disa raste me vdekje.⁷³

C. UNMIK-u shpërfilli paralajmërimet urgjente dhe nuk arriti të ndalonte ekspozimin ndaj plumbit të rrezikshëm

Ndërhyrja më e rëndësishme për të parandaluar helmimin nga plumbi është ndalimi i ekspozimit nëpërmjet heqjes së burimit të kontaminimit ose nëpërmjet zhvendosjes së banorëve nga mjedisi toksik.⁷⁴ Megjithatë, për gati një dekadë, OKB-ja nuk arriti t'i evakuojë PZHBV-të në vende të sigurta ose t'u siguronte atyre mbrojtjen e duhur nga plumbi toksik.

Pas marrjes së administratës së përkohshme të Kosovës, UNMIK-u fillimisht ndërmori veprime të kufizuara, por joadekuate për trajtimin e ndotjes. Pasi një auditim mjedisor konstatoi se miniera e shkëmbit të plumbit ishte një “burim i papranueshëm i ndotjes së ajrit”,⁷⁵ UNMIK-u mori kontrollin e operacioneve të saj dhe më vonë e mbylli atë në gusht të vitit 2000.⁷⁶ PSSP-ja në atë kohë, Bernard Kouchner, theksoi se “si mjek dhe si kryeadministrator i Kosovës, do të ndihesha jashtëzakonisht keq nëse do të lejoja vazhdimin qoftë edhe një ditë më shumë të këtij kërcënimi për shëndetin e fëmijëve dhe grave shtatzëna.”⁷⁷

Megjithatë, nga gushti i vitit 2000 deri në vitin 2004, veprimi i vetëm i UNMIK-ut për trajtimin e ekspozimit të vazhdueshëm ndaj plumbit ishte autorizimi i një raporti të brendshëm mbi ndotjen e shkaktuar nga plumbi në Mitrovicë, i cili kërkonte rekomandime se si të zbutte ekspozimin.⁷⁸ Siç është raportuar më vonë nga Human Rights Watch, ai raport vuri në dukje faktin se në atë kohë ndotja nga plumbi në Mitrovicë i kishte tejkaluar nivelet e pranueshme me 176 herë në bimësi dhe 122 herë në tokë.⁷⁹ Nivelet e plumbit në gjak ishin veçanërisht të larta tek PZHBV-të.⁸⁰ Por sipas ish-banorëve të kampit, UNMIK-u u ofroi “pak” ose aspak” informacion komuniteteve në kampe për këto të dhëna thelbësore dhe raportohet se ka pasur keqinformim dhe dezinformim rreth rreziqeve shëndetësore të lidhura me plumbin gjatë kësaj kohe.⁸¹

Raporti i brendshëm i UNMIK-ut për ndotjen nga plumbi rekomandonte gjithashtu një sërë masash specifike zbutëse, duke përfshirë kryerjen e studimeve gjithëpërfshirëse epidemiologjike dhe marrjen e mostrave të rregullta mjedisore, kryerjen e monitorimit dhe trajtimin periodik dhe sistematik të fëmijëve dhe grave shtatzëna, si dhe zhvendosjen e banorëve të kampit në një zonë më të sigurt.⁸² Raporti arriti në përfundimin se kostot e zbatimit të të gjitha strategjive do të tejkalonin aftësitë financiare të UNMIK-ut,⁸³ megjithatë sipas raportimeve UNMIK-u nuk ndërmori *ndonjë veprim* në tre vitet që pasuan - UNMIK-u nuk e bëri publik raportin, nuk e iu referoi situatën në Këshillin e Sigurimit, ose nuk ndërmori ndonjë hap për të zbutur ekspozimin ndaj plumbit në kampe.⁸⁴

“Ky është problemi më i rëndë humanitar dhe mjedisor i Evropës.”

- Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut (2009)

Në vitin 2004, aktivistët romë dhe organizatat e të drejtave të njeriut paralajmëruan komunitetin ndërkombëtar për rastet e helmimit simptomatik me plumb mes banorëve të kampit. Njerëzit vuanin nga konvulsione, çorientimi dhe dhimbja e kokës, ndërsa fëmijët shfaqnin shenja të mishrave të dhëmbëve në ngjyrë të zezë dhe kishin vështirësi në të aftësitë e të nxënësve.⁸⁵ Vdekja e një vajze katër vjeçare në kampin Zhikoc, pasi ajo u diagnostikua me helmim nga plumbi, u bë shkak që OBSH-ja të ndërmerre veprime.⁸⁶ Në verën e vitit 2004, OBSH-ja bëri një vlerësim të rrezikut shëndetësor në kampet e të zhvendosurve në Mitrovicë, i cili nxori në pah se shumica e fëmijëve në kampe kishin nivele të larta e të rrezikshme të plumbit në gjak dhe se 80% e tokës në kampe ishte “e pasigurt” për shkak të për kontaminimin me plumb.⁸⁷ OBSH-ja e paralajmëroi UNMIK-un në korrik dhe i tërhoqi vëmendjen përsëri në tetor të vitit 2004, për efektet e rënda dhe të pakthyeshme shëndetësore të helmimit me plumb, duke i ushtruar presion për evakuimin e menjëhershëm të fëmijëve dhe grave shtatzëna nga kampet.⁸⁸ OBSH-ja ishte e qartë në rekomandimet e saj për UNMIK-un: kampet duhej të mbylleshin menjëherë.⁸⁹

Ndërkohë që lajmet për nivelet e larta të toksicitetit në kampe dhe ndikimin e tyre shëndetësor mbi banorët u përhapën, aktivistët romë dhe organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë Amnesty International dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, i kërkuan UNMIK-un të largonte kampet.⁹⁰ Raportuesit Specialë të OKB-së për strehimin adekuat, mbetjet toksike dhe shëndetin i bënë bashkërisht thirrje UNMIK-ut që të vepronte sa më shpejt dhe të siguronte akomodim të pakontaminuar për komunitetet romë.⁹¹ Për më tepër, Raportuesi Special i OKB-së për të drejtat e Personave të Zhvendosur Brenda Vendit i kërkoi komunitetit ndërkombëtar “të evakuonte menjëherë PZHBV-të [...] dhe të siguronte burimet e nevojshme për këtë gjë pa asnjë vonesë”.⁹² Mosveprimi, paralajmëroi ai, “ishte i barabartë me shkeljen e të drejtave të fëmijëve të prekur për mbrojtjen e shëndetit dhe integritetit të tyre fizik”.⁹³

Në vitin 2005 – pesë vjet pas mbërritjes së romëve për herë të parë në kampe – UNMIK-u organizoi një grup pune të përbërë nga UNHCR-ja, OBSH-ja, OSBE-ja dhe KFOR-i për të zhvilluar një plan evakuimi dhe për të zvogëluar ekspozimin ndaj plumbit të PZHBV-ve.⁹⁴ Plani më i qëndrueshëm i zhvendosjes, sipas përcaktimit të grupit të punës, ishte lehtësimi i kthimit të PZHBV-ve në lagjen e Romëve në jug të Mitrovicës, pikërisht aty ku ata kishin banuar më parë.⁹⁵ Rindërtimi i Mëhallës së Romëve, e cila u shkatërrua masivisht në vitin 1999, kërkonte pak kohë. Si rrjedhim, task forca propozoi një zgjidhje të përkohshme: zhvendosjen e PZHBV-ve në kampin ushtarak të Osterodës, që më parë shfrytëzohej nga KFOR-i.⁹⁶



Fëmijë në Osterode me plumb që i del nga dhëmbët. Të drejtat e autorit: Darren McColleston.

Osterode ishte gjithashtu afër grumbujve të skorieve toksike, të vendosura vetëm 150 metra larg kampit Cesminluke.⁹⁷ Pasi UNMIK-u pastroi dhe rinovoi kampin, OBSH-ja dhe një ekip inxhinierësh të ushtrisë amerikane arritën në përfundimin se Osterode ishte më “i sigurt nga plumbi” sesa Cesminluke sepse kishte ujë të rrjedhshëm, ambiente më të mira sanitare dhe ishte i shtruar me beton.⁹⁸ Në periudhën mars - prill 2006, OKB-ja mbylli kampet e Zhikocit dhe Kablarës dhe i zhvendosi 593 PZHBV-të romë që jetonin atje në Osterode si një zgjidhje e përkohshme derisa të mund të realizohej përpjekja për rehabilitimin përfundimtar të Mëhallës së Romëve.⁹⁹ Megjithatë, shumica e 140 PZHBV-ve në Cesminlukës refuzuan të zhvendoseshin, sepse mendonin se Osterode ishte po aq i kontaminuar sa vendi ku ishin.¹⁰⁰ Siç konstatoi PKDNJ-ja në vendimin e tij të vitit 2016, përshkrimi i UNMIK-ut për Osterodes si “më i sigurt” se kampet e tjera ekzistuese, rezultoi të ishte “keqinformues”¹⁰¹. Në vitin 2011, pesë vjet pas zhvendosjes, CDC-ja konfirmoi se kampi i Osterodes ishte në fakt “larg faktit të mospranisë së plumbit” dhe përmbante “nivele të papranueshme plumbi” në tokë.¹⁰²

Si përfundim, UNMIK-u ia kaloi përgjegjësinë mbikëqyrëse për kampet qeverisë së Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.¹⁰³ Më në fund, Cesminluke u mbyll në vitin 2010 dhe Osterode në vitin 2012. Leposaviqi, kampi që ndodhej më larg minierës së Trepçës, u mbyll në vitin 2013, 14 vjet pas shpërnguljes së PZHBV-të romë në një bazë të supozuar të përkohshme.¹⁰⁴

D. UNMIK-u nuk mundi t'u siguronte banorëve të kampit analiza të vazhdueshme ose trajtim mjekësor për helmimin nga plumbi

Kur zbulohet plumbi në mjedis, analizat e vazhdueshme janë jetike për të zbuluar nivelet e larta të plumbit në gjak dhe për të diagnostikuar helmimin me plumb. Megjithatë, UNMIK-u nuk ka zbatuar kurrë një qasje sistematike për të analizuar nivelet e plumbit në gjak të PZHBV-ve apo për të monitoruar nivelet e tyre të përthithjes së plumbit. Në periudhën 2004-2006, OBSH-ja kreu tre raunde të analizave të gjakut për rreth 50 fëmijëve në çdo raund dhe ofroi ndihmë të përgjithshme për komunitetet romë.¹⁰⁵ Supozohet që UNMIK-u nuk ua ka paraqitur PZHBV-ve të prekur ose anëtarëve të familjeve të tyre rezultatet e analizave të gjakut të kryera nga OBSH-ja.¹⁰⁶ Përveç kësaj, analizat ishin të disponueshme vetëm në një masë të kufizuar me anë të përpjekjeve vullnetare të aktivistëve romë dhe punonjësve të shëndetësisë.¹⁰⁷ Megjithatë, analizat e gjakut të kryera në masë të kufizuar zbuluan në mënyrë të vazhdueshme nivele të larta e të rrezikshme të plumbit në gjak, shpesh duke tejkaluar nivelet që mund të zbulonin pajisjet mjekësore.¹⁰⁸ Tridhjetë për qind e fëmijëve që kryen analizat në periudhën 2005-2007 kishin nivele të plumbit në gjak mbi 45 µg/dL, gjë që kërkonte terapi me kelim,¹⁰⁹ që përfshin administrimin e substancave, molekulat e të cilave lidhen dhe neutralizojnë plumbin në trup dhe reduktojnë qarkullimin e plumbit në gjak.¹¹⁰

Megjithatë, siç theksoi PKDNJ-ja në opinionin e saj të vitit 2016, *N.M kundër UNMIK-ut*, “UNMIK-u nuk ofroi kujdes mjekësor aq sa duhej, madje lë shumë për të dëshiruar, për PZHBV-të e prekur, duke përfshirë ata që rezultuan se kishin nivele të larta të plumbit në gjak”.¹¹¹ Në vitin 2006, OBSH-ja ofroi kryerjen e terapisë me kelim për PZHBV-të që vuanin nga helmimi i rëndë me plumb në Osterode si një “ndërhyrje urgjente” sepse UNMIK-u kishte premtuar se “të gjitha këto komunitete do të zhvendoseshin brenda gjashtë muajve”.¹¹² Megjithatë, pa eliminuar ekspozimin ndaj plumbit, terapia me kelim mund të lehtësojë thithjen e plumbit nga trupi,¹¹³ duke përforcuar edhe njëherë rëndësinë e heqjes së çdo burimi të vazhdueshëm të ekspozimit ndaj plumbit përpara kryerjes së terapisë së kelimit. Meqenëse zhvendosja nga Osterode në kohë e duhur nuk ndodhi, OBSH-ja e ndërpreu terpinë me kelim vetëm pak muaj pas fillimit të saj.¹¹⁴ Duke mos mundur të realizojë zhvendosjen e PZHBV-ve larg burimit të kontaminimit, UNMIK-u në mënyrë efektive pengoi mundësinë që kishin banorët e kampit për marrjen e këtij trajtimi si një ndërhyrje e mundshme.¹¹⁵

Për më tepër, dështimi i UNMIK-ut për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme kujdes mjekësor, higjienë dhe ushqimin e duhur për të gjithë banorët e kampit, përfshirë ata që rezultuan me nivele të larta të plumbit në gjak, si dhe mbikëqyrja e kampeve ka të ngjarë të kenë përkeqësuar efektet negative shëndetësore të ekspozimit ndaj plumbit.¹¹⁶ Për më tepër, UNMIK-u ndërpreu në mënyrë të papritur të gjitha analizat e gjakut, terpinë me kelim dhe masat ndërhyrëse të ushqyerjes në vitin 2007, duke pretenduar se këto ndërhyrje mjekësore “nuk ishin më të domosdoshme”, pavarësisht ekspozimit të vazhdueshëm të banorëve ndaj kontaminimit me plumb.¹¹⁷

II. KOMUNITETET ROME PËRJETOJNË DËME TË VAZHDUESHME NGA HELMIMI ME PLUMB

Prej më shumë se dy dekadash kur PZHBV-të u strehuan në kampe zhvendosjeje të improvizuara, ish-banorët e kampeve përjetojnë dëme të vazhdueshme prej helmimit nga plumbi, të cilat përkeqësohen nga moskompensimi nga ana e OKB-së.

Hetimet e nga Human Rights Watch, Shoqëria për Popujt e Kërcënuar (SHPK) dhe Raportuesi Special për Lëndët Toksike dhe të Drejtat e Njeriut kanë dokumentuar një sërë simptoma mjekësore të vazhdueshme të banorëve të ish-kampit që përputhen me helmimin me plumb.¹¹⁸ Në vitin 2017, SHPK-ja intervistoi përfaqësues nga 50 familje rome që kishin kaluar vite të tëra në kampet e kontaminuara në lidhje me gjendjen e tyre aktuale shëndetësore.¹¹⁹ SHPK-ja zbuloi se problemet e vazhdueshme shëndetësore më të shpeshta të cilat ishin raportuar përfshinin dobësi të muskujve, probleme të kujtesës, probleme me sytë, dobësi të sistemit imunitar dhe probleme me zorrët ose dhimbje stomaku - të gjitha këto janë simptoma që lidhen me helmimin nga plumbi.¹²⁰ Të intervistuarit raportuan gjithashtu se fëmijët e tyre, disa prej të cilëve kishin lindur ose ishin rritur në kampe, po përjetonin probleme me kujtesën, çrregullime të të folurit, nervozizëm, dhimbje stomaku, çrregullime motorike, kriza dhe probleme të sjelljes.¹²¹ Aftësitë e kufizuara intelektuale, problemet e zhvillimit dhe çrregullimet e sjelljes janë simptoma të zakonshme të helmimit nga plumbi tek fëmijët, të cilët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj helmimit me plumb, sepse e thithin plumbin më lehtë se të rriturit.¹²²

Human Rights Watch intervistoi gjithashtu 19 viktimat të helmimit me plumb dhe familjet e tyre në vitin 2017.¹²³ Një grua pohoi se djali i saj, i cili u rrit në një nga kampet e kontaminuara dhe rezultoi pozitiv me helmim nga plumbi kur ishte vetëm nëntë muajsh, përjetoj konvulsione të rregullta derisa në moshën shtatë vjeçare.¹²⁴ Në moshën 16-vjeçare, u desh të përballej me humbjen e kujtesës dhe e kishte të vështirë të përqendrohej në shkollë.¹²⁵ Sheribania, një grua 45-vjeçare, u shpreh për Human Rights Watch se ajo kishte rezultuar pozitive ndaj helmimit me plumb në periudhën që jetonte në kampin e Zhikocit.¹²⁶ Ajo më pas përjetoj simptoma të helmimit nga plumbi dhe tani vuan nga problemet e zemrës, probleme me veshkat dhe lodhja kronike.¹²⁷

Këto gjetje u përforcuan nga Raportuesi Special për Lëndët Toksike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili mblodhi dëshmi nga anëtarët e prekur të komunitetit rom në vitin 2019. Kjo dëshmi konfirmoi se shumë ish-banorë të kampit vazhdonin të përjetonin probleme shëndetësore të lidhura me helmimin nga plumbi, si p.sh. konvulsione, sëmundje të veshkave dhe çrregullime të sjelljes dhe emocionale.¹²⁸

“[Kombet e Bashkuara] u shprehën që do të na kompensonin por kurrë nuk na dhanë asgjë.”

- Nënshetas britanik, banor i mëparshëm i kampit të Zhikoc-it/Zitkovac-it.
Intervistë me Opre Roma Kosovo (2022)

Intervistat e kohëve të fundit, që janë kryer me OPRE Roma Kosovo në tetor 2020, shkojnë në të njëjtën linjë me hetimet e mëparshme: ish-PZHBV-të kanë vazhduar të vuajnë nga probleme të rënda shëndetësore dhe sfida socioekonomike pas mbylljes së kampeve.

Briton, një ish-banor i kampit Zhikoc/Zitkovac, iu tregoi intervistuesve rreth mbesës së tij, e cila kishte ndërruar jetë në moshën 10-vjeçare për shkak të problemeve shëndetësore që lidheshin me helmimin e dyshuar nga plumbi.¹²⁹ Sot djali i tij vuan nga probleme të vazhdueshme njohëse që lidhen me ekspozimin ndaj plumbit helmues.¹³⁰ Megjithatë, kostoja e trajtimit mjekësor është e lartë: “Një vizitë te mjeku kushton 300 dollarë, thjesht sa për të kryer disa analiza dhe për të parë si po ecën gjendja.” – i tha Briton OPRE Roma Kosovo.¹³¹

Varfëria dhe pengesat financiare i pengojnë shumë banorë të ish-kampit, të cilët u zhvendosën në Mëhallën e Romëve pas rindërtimit të saj në vitin 2007, të mos marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore dhe trajtim mjekësor. Simptomat e vazhdueshme të helmimit nga plumbi dhe mungesa e aksesit ndaj kujdesit mjekësor janë veçanërisht alarmuese në kontekstin e pandemisë së COVID-19, pasi shumë nga problemet shëndetësore ekzistuese i bëjnë viktimat më të cenueshme ndaj vdekjes ose pasojave afatgjata nga SARS-CoV-2.¹³²

Shumë banorë të Mëhallës së Romëve jetojnë në varfëri ekstreme, duke marrë ndihmë të kufizuar sociale ose duke punuar në punë me të ardhura të ulëta.¹³³ “Na duhet t’i çojmë fëmijët në shkollë, ndaj kemi nevojë për ndihmë financiare.” – Habib, një ish-banor kampi, i tha OPRE Roma Kosovo.¹³⁴ “Kjo është arsyeja përse thonë që romët janë të paarsimuar. Nuk është se nuk duam t’i çojmë fëmijët [në shkollë], por nuk kemi mbështetje financiare.”¹³⁵

Programet qeveritare dhe jofitimprurëse kanë ofruar pak ndihmë për viktimat e helmimit nga plumbi në kuadër të këtyre sfidave socioekonomike. Sipas Human Rights Watch, “[ndërkohë që qeveria e Kosovës ofron disa shërbime shëndetësore falas, qendrat shëndetësore aty pranë [Mëhallës së Romëve] nuk mund të ofrojnë të gjitha shërbimet për të cilat kanë nevojë njerëzit që kanë vuajtur nga helmimi nga plumbi dhe shpesh kërkojnë që pacientët të paguajnë për mjekimin e marrë.”¹³⁶ Sipas një hetimi të zhvilluar nga Advancing Together, në vitin 2018 mungonin programet e shënjestruara për t’i mbështetur viktimat e helmimit nga plumbi, dhe ndonëse ndonjëherë viktimat mund të marrin ndihma të vogla nga autoritetet kombëtare dhe organizatat jofitimprurëse, kjo mbështetje “nuk ka qenë kurrë e mjaftueshme krahasuar me nevojat për përmirësimin e shëndetit të këtij grupi qytetarësh, duke marrë parasysh që helmimi nga plumbi ka shkakuar sëmundje dhe degjenerim të rëndë, për të cilët ndonjëherë nevojitet trajtim i vazhdueshëm mjekësor.”¹³⁷

“Askush nuk na jep barna për fëmijët tanë të sëmurë. Nuk kemi pasur ndihmë as me pilulat, as me injeksionet, dhe as me analizat”.

- Hazbije H., Video-intervistë me Human Rights Watch (2017)

Naim M., baba i shtatë fëmijëve, u shpreh për Human Rights Watch se pasi humbi një nga vajzat e tij si pasojë e helmimit nga plumbi, ai vazhdoi të përpiqej për të përballuar trajtimet mjekësore për gruan e tij dhe vajzën tjetër, të cilat vazhduan të vuanin nga efektet negative shëndetësore.¹³⁸ Siç u shpreh Elhame H., një nënë e re: “Nëse nuk keni para, mjeku do ju jep vetëm diagnozën, por nuk mund të blini ilaçe”.¹³⁹

Për shumë ish-banorë të kampit, mjetet e përshtatshme juridike i kërkojnë OKB-së që të zbatojë rekomandimet e panelit të vetë për të drejtat e njeriut, duke ofruar kompensim individual për viktimat e helmimit nga plumbi.¹⁴⁰ “Ata thanë që do të na kompensonin, por nuk na dhanë asgjë,” – Briton i tha OPRE Roma Kosovo në tetor. “Ne nuk duam që [kompensimi] t’i jepet asnjë OJF-je... duhet t’i jepet çdo familjeje që ka fëmijë të sëmurë prej helmimit nga plumbi.”¹⁴¹

III. OKB-ja SHMANGU PËRGJEGJËSITË DUKE BLOKUAR QASJEN NË DREJTËSI

Për më shumë se një dekadë, komunitetet e prekura rome kanë kërkuar me këmbëngulje zgjidhje nga OKB-ja. Pavarësisht detyrimit të UNMIK-ut për t’iu përmbajtur ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, i cili përfshin të drejtën për një mjet juridik efektiv, dhe detyrimet e veta të brendshme për të zgjidhur ankesat, OKB-ja pengoi dhe vonoi përpjekjet ligjore të viktimave në çdo hap që hidhnin. Kur viktimat kërkuan korrigjim përmes PKDNJ-së, OKB-ja ndryshoi rregullat procedurale të PKDNJ-së për t’i hequr juridiksionin dhe u përpoq në mënyrë të vazhdueshme të ndalonte procedurat. Intransigjenca e OKB-së në mënyrë të vazhdueshme i riviktimizoi komunitetet rome duke i futur në grackën e një procesi të gjatë duke premtuar kompensim, por në fund e ndihmoi OKB-në të shmangte përgjegjësinë. Përmes veprimeve të veta, OKB-ja u tall me mekanizmat e saj të llogaridhënies, duke minuar pozitën e saj morale si përkrahëse ndërkombëtare e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

A. Detyrimet e UNMIK-ut për të Drejtat e Njeriut

Sipas ligjit ndërkombëtar dhe rregulloreve të OKB-së, UNMIK-u kishte për detyrim të mbronte dhe të promovonte të drejtat e njeriut të komuniteteve rome duke mos shkelur në radhë të parë të drejtat e tyre dhe duke ofruar akses në mjetet juridike për lëndimet që kanë pësuar. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, e cila vendosi mandatin e UNMIK-ut në Kosovë, e bëri UNMIK-un përgjegjës për “mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut”¹⁴² dhe “sigurimin e kthimit të sigurt dhe pa pengesa të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur”.¹⁴³ Në një raport të veçantë që shoqëron rezolutën, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan përsëriti detyrimet e UNMIK-ut për të drejtat e njeriut në Kosovë, duke specifikuar se “UNMIK-u do të udhëhiqet nga standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si bazë për ushtrimin e autoritetit të tij në Kosovë.”¹⁴⁴ Në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24, Mbi Ligjin e Zbatueshëm në Kosovë, UNMIK-u ritheksoi zotimin e tij për respektimin e “standardeve të njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” sipas përcaktimeve të traktateve kryesore të të drejtave të njeriut dhe të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.¹⁴⁵ Në të vërtetë, Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, i ngarkuar me monitorimin e pajtueshmërisë së shteteve me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, vuri në dukje se mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut është “një nga përgjegjësitë kryesore që i janë dhënë UNMIK-ut sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit”.¹⁴⁶ Si rrjedhim, sipas Komisionit, UNMIK-u ishte “i detyruar të respektonte dhe t’u siguronte të gjithë individëve brenda territorit të Kosovës dhe atyre që ishin subjekt i juridiksionit të tyre të drejtat e njohura në Marrëveshje”.¹⁴⁷ Respektimi i të drejtave të njeriut, me fjalë të tjera, ishte “i inkorporuar siç duhet në mandatin e UNMIK-ut”.¹⁴⁸

Viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë të drejtën e një mjeti juridik efektiv. E drejta është e sanksionuar në traktatet kryesore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë traktatet detyruese të UNMIK-ut, dhe konsiderohet e drejtë ndërkombëtare zakonore.¹⁴⁹ E drejta për mjete efektive juridike përfshin si aspektin procedural, ashtu edhe atë material. Mjetet e efektshme juridike duhet të jenë “të menjëhershme, të aksesueshme, të disponueshme përpara [organeve të pavarura] dhe të shpiten drejt “riparimit dhe, sipas rastit, ndaljes së dëmeve.”¹⁵⁰ Në aspektin procedural, ai kërkon që viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut t’u ofrohet akses në organet e pavarura përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ku ata të kenë mundësinë të dëgjohen në një seancë të drejtë dëgjimore.¹⁵¹ Në thelb, kjo nënkupton faktin që viktimat kanë të drejtë për dëmshpërblime për lëndimet e pësuar si rezultat i shkeljeve të të drejtave të njeriut.¹⁵² OKB-ja ka përcaktuar dëmshpërblimet të cilat përfshijnë: kompensimin për dëmet materiale, jo materiale dhe morale rehabilitimin, duke përfshirë shërbimet mjekësore dhe psikologjike për viktimat; kënaqësinë për njohjen e dëmit të shkaktuar; garancitë e mospërsëritjes për të parandaluar dëmet në të ardhmen; dhe kthimin e viktimës në gjendjen në të cilën ndodhej para shkeljes.¹⁵³

“Askujt nuk i interesojnë dymbëdhjetë, trembëdhjetë vitet tona të vuajtjes në kampe. Nuk na pyet askush “Si është fëmija yt? A është shëruar? A ka ndonjë problem? A ka ndonjë dëm?””

- Latif M., Ish-drejtues kampi në Cesminluke/Česmin Lug, Intervistë në video me Human Rights Watch (2017)

B. Korniza e Përgjegjshmërisë së OKB-së

Pavarësisht obligimeve të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut, viktimat rome e gjetën veten në një vakum të plotë llogaridhënie. E gjithë kjo vjen si rezultat i dy arsyeve kryesore: pushteti gjithëpërfshirës dhe i pakontrolluar i UNMIK-ut gjatë funksionimit si qeveri *de facto* e Kosovës, dhe regjimi i imunitetit të OKB-së, i cili e mbron OKB-në nga paditë e bëra në gjykata dhe e lë kompensimin për dëmtimet në diskrecionin e vetë organizatës.¹⁵⁴

Së pari, UNMIK-u gëzonte “pushtet pothuajse të pakufizuara”¹⁵⁵ në Kosovë pa rrugë efektive për llogaridhënie.¹⁵⁶ OKB-ja i dha UNMIK-ut “të gjithë autoritetin legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e gjyqësorit”.¹⁵⁷ Funksionet e tij qeveritare përfshinin zbatimin e ligjit, mbledhjen e taksave, gjykimin e mosmarrëveshjeve pronësore dhe detyrimet për dëmet e luftës, funksionimin e sistemeve arsimore dhe mbledhjen e mbeturinave.¹⁵⁸ Megjithatë, ndryshe nga një shtet, UNMIK-u nuk iu përmbajt parimeve të tilla si ndarja e pushteteve, nuk ushtroi kontrole dhe nuk ofroi ekuilibër mbi autoritetin e tij gjithëpërfshirës dhe nuk kishte asnjë sistem të pavarur gjyqësor apo mekanizëm mbikëqyrës që mund të nxiste llogaridhënien.¹⁵⁹

Ky rol jashtëzakonisht i gjerë në Kosovë erdhi si rezultat i imunitetit që gëzonte OKB-ja nga padia. Konventa e 1946-ës për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara (KPIKB) parashikon që OKB-ja “të gëzojë imunitet nga çdo formë e procesit ligjor”.¹⁶⁰ Imuniteti synon të mbrojë aftësinë e OKB-së për të kryer misionin e saj kryesor – duke përfshirë nxitjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe promovimin e të drejtave të njeriut – pa lejuar ndërhyrje nga shtetet anëtare që mund të kenë interes të pengojnë punën e organizatës.¹⁶¹ Nga ana tjetër, kjo është e rëndësishme për të siguruar praninë e vazhdueshme të OKB-së në disa nga mjediset më të pasigurta të botës.¹⁶² Megjithatë, imuniteti i OKB-së e mbron atë vetëm nga paditë e ngritura në gjykata dhe në asnjë mënyrë nuk e çliron atë nga përgjegjësia ligjore për të ofruar mjete juridike efektive për viktimat.

Mekanizmat e Përgjegjshmërisë së Përgjithshme të OKB-së

Ndërkohë që mbron OKB-në nga veprimet në gjykatat kombëtare, KPIKB-së kërkon gjithashtu që organizata të “përcaktojë dispozita për mënyrat e duhura të zgjidhjes së... mosmarrëveshjeve që janë me natyrë të së drejtës private”.¹⁶³ Ky detyrim i shërben qëllimit kryesor për të siguruar që civilët e lënduar nga operacionet e OKB-së të kenë aftësinë për të kërkuar kompensim, në përputhje me ligjin për të drejtat e njeriut që mbron të drejtën për një mjet juridik efektiv.¹⁶⁴

Ndërkohë që KPIKB-ja nuk përkufizon “ankesat e së drejtës private”, ato zakonisht konsiderohen si kërkesa kontraktuale ose dëmshpërblime të paraqitura nga qytetarët privatë kundër OKB-së,¹⁶⁵ të tilla si “pretendimet e palëve të treta...për lëndime personale, sëmundje ose vdekje” që lindin ose i atribuohen OKB-së.¹⁶⁶ Pra, ankesat e së drejtës private mund të dallohen nga ankesat që përballen me “funksionet politike ose politikëbërëse të Organizatës”¹⁶⁷ ose “përmbushjen aktuale të funksioneve kushtetuese [të OKB-së]”.¹⁶⁸

Kërkesat për kompensim të paraqitura në përputhje me KPIKB-së zakonisht vendosen nga ZÇL-ja në selinë e OKB-së në Nju Jork, ose nga zyrat lokale të ankesave të ngritura brenda një misioni të caktuar.¹⁶⁹ Në kontekstin paqeruajtës, OKB-ja është gjithashtu e detyruar të ngrejë komisione për trajtimin e ankesave për të dëgjuar ankesat për lëndime personale, por faktikisht komisione të tilla nuk janë krijuar kurrë.¹⁷⁰

Vëzhguesit kanë ngritur shqetësimin se ky sistem i lejon OKB-së të marrë vendime të pjesshme dhe me interesa personale pa transparencë.¹⁷¹ Siç e ka pranuar dhe vetë Sekretari i Përgjithshëm, procesi e vendos “hetimin, procedurat ligjore dhe gjykimin përfundimtar të ankesave tërësisht në duart e Organizatës.”¹⁷² I pandehuri, përkatësisht OKB-ja, është gjithashtu gjykatësi, duke ngritur pikëpyetje serioze për drejtësinë dhe pavarësinë e procesit të kërkesës nga palët e treta.¹⁷³ Në veçanti, avokatëve të OKB-së - roli i të cilëve është mbrojtja në interesin më të mirë të organizatës - u është besuar gjithashtu të bëjnë përcaktime të paanshme mbi ankesat.¹⁷⁴

Për më tepër, duke qenë se ZÇL-ja nuk i publikon vendimet, është e vështirë të konstatohet se deri në çfarë mase kompenson OKB-ja përmes këtij sistemi.¹⁷⁵ Në një rast të ngjashëm viktimat kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara nga sëmundja e kolerës në Haiti si

rezultat i neglizhencës së OKB-së, megjithatë, ZÇL-ja u kritikua ashpër për hedhjen poshtë të ankesave si “të paarrtshme” pavarësisht marrëveshjes në shkallë të gjerë mes ekspertëve ligjorë që rasti përbënte një pretendim privat ligjor.¹⁷⁶

Mekanizmat shtesë të llogaridhënies në Kosovë

Në Kosovë, OKB-ja parashikoi mekanizma shtesë për të ofruar alternativa më të pavarura ndaj procesit të ZÇL-së, por edhe ato nuk arritën të ofrojnë mënyra për rekurs ligjor. Një komision ankesash që supozohej të ngrihej në vitin 2000 për të dëgjuar pretendimet e palëve të treta për lëndime personale, sëmundje ose vdekje që rrjedhin ose që i atribuohen drejtpërdrejt UNMIK-ut ose personelit të tij, sipas të dhënave nuk është themeluar.¹⁷⁷ Në vitin 2000 u krijua një institucion i Avokatit të Popullit për të shqyrtuar abuzimet me autoritetin, por në vitin 2006, UNMIK-u i hoqi atij kompetencat për të hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut nga institucionet ndërkombëtare, përfshirë UNMIK-un.¹⁷⁸

Kritikat ndërkombëtare për mungesën e llogaridhënies në Kosovë filluan të shtohen në fillim të viteve 2000. Komisioni i Venecias, një organ këshillimor i Këshillit të Evropës, arriti në përfundimin në vitin 2004 se UNMIK-u nuk ofroi “asnjë mekanizëm efektiv që u mundëson individëve, të drejtat e të cilëve janë shkelur, të nisin procedurat” kundër tij.¹⁷⁹ Raporti i Komisionit shërbeu si shtysë për krijimin e PKDNJ-së në vitin 2006. Një organ i pavarur, quasi- gjyqësor, PKDNJ-ja ishte përgjegjëse për shqyrtimin e “ankesave të bëra nga çdo person apo grup individësh që pretendonin se ishin viktimë e shkeljes së [të drejtave të njeriut] nga UNMIK-u.”¹⁸⁰ PKDNJ-ja ishte e autorizuar të merrte vendime mbi pranueshmërinë dhe themelin e ankesës, gjetjet e çështjes dhe t’i bënte rekomandime UNMIK-ut.¹⁸¹ Ndryshe nga procesi jotransparent i ankesave të ZÇL-së, procedurat për iniciimin e ankesës dhe gjykimin e rasteve ishin të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të disponueshme për publikun në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/12 dhe në Rregulloren e Punës të PKDNJ-së. Çështjet u paraqitën në gjyq përpara një trupe prej tre gjyqtarësh të autorizuar për të zhvilluar seanca dëgjimore, për të shqyrtuar provat dhe për të thirrur dëshmitarë.¹⁸² Duke pasur këtë autoritet, krijimi i PKDNJ-së përfaqësoi një mundësi për të kapërcyer hendekun e llogaridhënies të krijuar nga regjimi i imunitetit të OKB-së.

C. Përpjekjet e viktimave për të aksesuar mjetet juridike efektive

▶ Viktimat kërkojnë mjete juridike përmes procesit të pretendimeve nga palët e treta

Në vitin 2006, para se të themelohej PKDNJ-ja, 122 banorë të kampit të përfaqësuar nga avokatja amerikane Dianne Post paraqitën ankesa përmes procesit të kërkesave nga palët e treta pranë ZÇL-së në Nju Jork.¹⁸³ Ankesa kërkonte kompensim për dëmtimin e rëndë dhe të pakthyeshëm shëndetësor që ata pësuan për shkak të helmimit nga plumbi, si dhe për humbjen e të ardhurave, shpenzimet mjekësore dhe rehabilitimin, shpenzimet e transportit që lidhen me kujdesin mjekësor dhe shpenzimet e varrimit për ata individë, që humbën anëtarët e familjes si rezultat i helmimit me plumb.¹⁸⁴ OKB-ja i vonoi këto kërkesa për pesë vjet pa ofruar asnjë lloj transparence në procesin e vlerësimit të saj.

Rrugëtim 15-vjeçar duke kërkuar drejtësi nga OKB-ja



Shkurt 2006



122 viktime depozitojnë ankesa në Zyrën e OKB-së për Çështje Ligjore (ZÇL) në procesin e ankesave nga palë të treta.



Mars 2006

OKB-ja krijon Panelin Këshillimor për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), një organ i pavarur quasi-gjyqësor, për të marrë vendime rreth çështjeve në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut nga UNMIK-u.



Qershor 2009



PKDNJ-ja e konsideron çështjen pjesërisht të pranueshme dhe vazhdon me shqyrtimin në themel.



Shtator 2008



UNMIK-u menjëherë vendos se PKDNJ-së i ndalohet të trajtojë çështjen ndërkohë që ankesat janë pezull në ZÇL.



Korrik 2008



143 viktime depozitojnë çështjen N.M k. UNMIK pranë PKDNJ-së.



Tetor 2009



UNMIK-u ndryshon rregullat e PKDNJ-së, duke e zhveshur nga juridiksioni mbi çështje që mund të zgjidhen nga ZÇL-ja dhe duke e detyruar të pushojë çështjen N.M k. UNMIK. Gjithashtu, UNMIK-u prezanton një afat të ri 6-mujor për të hapur çështje pranë PKDNJ-së, duke e kufizuar mundësinë e viktimave që të kthehen te PKDNJ-ja pasi çështja të jetë pushuar nga ZÇL-ja.



Mars 2010



PKDNJ-ja e pushon çështjen si rrjedhojë e ndryshimit të rregullit.



31 Mars 2010

Data e fundit për të hapur çështje përpara se PKDNJ-ja të fillojë të zbatojë rregullat e reja të UNMIK-ut.



2012–2014



UNMIK-u vazhdon të mos u përgjigjet kërkesave të PKDNJ-së për të komentuar rreth themelit të çështjes.



Qershor 2012



PKDNJ-ja e rihap çështjen pavarësisht kundërshtimeve të UNMIK-ut, duke cituar nocionet bazë të drejtësisë.



Korrik 2011



Pas pesë vitesh rishikim dhe pas datës së fundit për të depozituar çështje pranë PKDNJ-së, ZÇL-ja i shpall ankesat si "të papranueshme".



Shkurt 2016



PKDNJ-ja vendos në favor të viktimave, duke konstatuar se UNMIK-u ka shkelur të drejtat e njeriut dhe duhet të ofrojë kompensim.



Maj 2017



Sekretari i Përgjithshëm, Guterres, shpall ngritjen e një fondi besimi për projekte komunitare, duke shpërfillur thirrjen e PKDNJ-së për kompensim.



2017–Aktualisht

Deri tani, OKB-ja nuk e ka financuar fondin e besimit dhe nuk ka ofruar asnjë kompensim për viktimat.



Zyra e OKB-së për Çështje Ligjore (ZÇL)



Panel Këshillimor për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ)

Në vitin 2009, banorët e kampit të përfaqësuar nga firma ligjore britanike Leigh Day paraqitën një tjetër ankesë pranë ZÇL-së, duke kërkuar zhvendosje, trajtim mjekësor dhe kompensim për kostot e rehabilitimit dhe humbje të tjera financiare.¹⁸⁵

Midis 2006 dhe 2010, ZÇL-ja iu përgjigj ankesave të të dy grupeve për përditësime të statusit duke pohuar në mënyrë të prerë se “po vazhdonte shqyrtimin e saj të çështjes.”¹⁸⁶ Ajo vazhdimisht vuri në dukje “kompleksitetin e çështjes”¹⁸⁷ dhe ofroi premtime iluzive të “përgjigjeve thelbësore”¹⁸⁸ në të ardhmen e afërt. ZÇL-ja nuk arriti t’u njoftonte viktimave ose përfaqësuesve të tyre ligjorë statusin e ndonjë hetimi dhe nuk ofroi asnjë provë se ishte e përfshirë me kompleksitetin e supozuar të ankesës. UNMIK-u gjithashtu refuzoi shprehimisht të takohej me Leigh Day për të diskutuar protokollet për hetim dhe zgjidhje.¹⁸⁹

Viktimat parashtrjnë ankesat në PKDNJ

Pasi OKB-ja themeloi PKDNJ-në në 2007, një grup prej 143 banorësh të kampit parashtruan një ankesë përpara këtij organi në 2008.¹⁹⁰ Ankuesit argumentuan se kampet e PZHBV-ve të kontaminuara me plumb shkaktuan dëme të mëdha në shëndetin e tyre. Ata pretenduan se duke i vendosur ata në kampe të njohura si shumë të kontaminuara dhe duke mos e treguar informacionin në lidhje me rreziqet shëndetësore dhe trajtimin e nevojshëm mjekësor, dhe duke dështuar në zhvendosjen e tyre në një mjedis të sigurt, UNMIK-u shkeli të drejtat e tyre njerëzore, duke përfshirë të drejtën për jetë dhe të drejtën për shëndet.¹⁹¹ Ankuesit theksuan se kushtet e mjerueshme të jetesës në kampe jo vetëm që ndikuan në përkeqësimin e shëndetit të tyre, por gjithashtu u mohuan atyre të drejtën për një standard të përshtatshëm jetese.¹⁹² Ata më tej parashtruan se paaftësia e UNMIK-ut për t’i larguar ata nga kampet e kontaminuara me plumb ishte “vetëm njëri nga incidentet e modelit të praktikës diskriminuese nga aktorët privatë dhe publikë”¹⁹³ kundër romëve në Kosovë. Ata pretenduan se të gjitha shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut duhet të lexohen në lidhje me të drejtën për të qenë të lirë nga diskriminimi.¹⁹⁴

UNMIK-u pretendon se nuk janë shterur mënyrat e tjera në dispozicion për të ndalur procedimet e PKDNJ-së

OKB-ja fillimisht u përpoq të pezullonte procedimet e PKDNJ-së sapo grupi parashtroi ankesën e tyre në vitin 2008. Pas dy vjet e gjysmë mosveprimi të ZÇL-së për pretendimet e veçanta të palëve të treta, UNMIK-u argumentoi se shqyrtimi i vazhdueshëm i ZÇL-së megjithatë nënkuptonte se PKDNJ-ja nuk mund ta dëgjonte çështjen për shkak se rrugët alternative të rekursit nuk ishin shfrytëzuar.¹⁹⁵

Ankuesit e kundërshtuan këtë, duke argumentuar se ata nuk kishin akses në mjete juridike efektive për shkak të mosndërmarrjes së tejzgjatur të veprimeve të ZÇL-së, imunitetit të organizatës dhe mungesës së institucioneve alternative në Kosovë me juridiksion mbi këtë çështje.¹⁹⁶ Ata theksuan se kishin vite që nuk kishin marrë ndonjë përgjigje kuptimplotë nga ZÇL-ja apo ndonjë entitet tjetër i OKB-së në lidhje me këtë çështje, kur thjesht u tha se OKB-ja “po bënte të pamundurën për të zgjidhur problemin.”¹⁹⁷

PKDNJ përfundimisht e konsideroi çështjen të pranueshme në qershor 2009, duke pranuar se çështja e mjeteve alternative ishte adresuar në mënyrë më të përshtatshme në themel.¹⁹⁸

UNMIK-u ndryshon rregullat e PKDNJ-së për t'ia hequr juridiksionin

Pasi PKDNJ vendosi që çështja ishte e pranueshme dhe filloi të shqyrtonte rastin në themel, UNMIK-u ndërmori hapin e jashtëzakonshëm të rishikimit të rregullave procedurale të Panelit për të kufizuar në mënyrë drastike operacionet e PKDNJ-së. Udhëzimi Administrativ nr. 2009/1 u dha në tetor 2009, dhe e ngushtoi ndjeshëm fushën e ankesave të pranueshme nga PKDNJ-ja në dy mënyra. Së pari, Udhëzimi deklaroi se “çdo ankesë që është ose mund të bëhet në të ardhmen objekt i procesit ose procedurave të KB-së për Pretendimet e palëve të treta [...] do të konsiderohet e papranueshme.”¹⁹⁹ Duke përjashtuar edhe këto pretendime që teorikisht mund t'i nënshtroheshin procesit të pretendimeve të palëve të treta, UNMIK-u e zvogëloi në mënyrë të konsiderueshme fushëveprimin e juridiksionit të PKDNJ-së, duke e kufizuar atë në ankesat që tashmë ishin hedhur poshtë përmes procesit të pretendimeve të palëve të treta ose që nuk ishin kontestime të mundshme me karakter të së drejtës private.²⁰⁰

Së dyti, UNMIK-u caktoi një afat arbitrar gjashtëmuor për çdo ankesë të ardhshme që do të dorëzohet, duke deklaruar se “asnjë ankesë nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga [PKDNJ] më vonë se 31 mars 2010.”²⁰¹ Rrjedhimisht, sipas këtij rregulli të ri, në rast se ZÇL-ja hodhi poshtë ankesat që banorët e kampit i paraqitën ZÇL-së në vitin 2006 diku pas 31 marsit 2010-mundësi e dallueshme duke pasur parasysh se ankesat tashmë zvarriteshin në ZÇL për rreth tre vjet pa progres - më pas, paditësit romë do të ndaloheshin nga kthimi i çështjes në PKDNJ pasi të kishin shteruar procesin e pretendimeve të palëve të treta.

Urdhri administrativ efektivisht e detyroi PKDNJ-në të pushojë çështjen, duke “e hequr juridiksionin nga Paneli”.²⁰² Megjithatë, PKDNJ-ja rezervoi të drejtën për të rihapur çështjen e ankuesve, edhe nëse ZÇL-ja i hodhi poshtë ankesat e tyre diku pas 31 marsit 2010.²⁰³ PKDNJ-ja përcaktoi se për shkak se tashmë e kishte konsideruar ankesën të pranueshme kur ishte paraqitur, çdo rezultat tjetër “do të ofendonte nocionet themelore të drejtësisë.”²⁰⁴

ZÇL-ja refuzon pretendimet e palëve të treta

Më 25 korrik 2011, mbi pesë vjet që kur grupi i parë i banorëve të kampit paraqiti pretendimet e tyre për palët e treta, ZÇL-ja e hodhi poshtë çështjen në mënyrë të përmbledhur në një letër prej dy faqesh. Duke përmendur “historinë e gjatë të rajonit të Mitrovicës të ndotjes së madhe industriale, duke përfshirë kontaminimin me plumb nga miniera e Trepçës”, Këshilli Ligjor i OKB-së pohoi se dëmi i shkaktuar rezultoi nga “rreziqet e përhapura të shëndetit dhe mjedisit që lindin në kontekstin e situatës së pasigurt të sigurisë në Kosovë.”²⁰⁵ Duke pranuar se ankesat përbënin “një rishikim të mandatit të UNMIK-ut si administratë e përkohshme në Kosovë”, dhe për rrjedhojë nuk “përbënin [ankesa të] karakterit të së drejtës private”, ZÇL-ja i hodhi poshtë si të papranueshme.²⁰⁶

Hedhja poshtë e ZÇL-së përbëhej nga dy paragrafë që përmbanin arsyetime të pakta që nuk artikulonin një standard ligjor ose nuk citonin ndonjë ligj përkatës në mbështetje të

vendimit. Natyra e përciptë e hedhjes poshtë është veçanërisht befasuese pasi ZÇL kishte theksuar vazhdimisht “kompleksitetin e çështjes”²⁰⁷ si arsye e vonës së madhe.

Në nëntor 2011, Leigh Day kundërshtoi hedhjen poshtë në një letër drejtuar Nën Sekretarit të Përgjithshëm.²⁰⁸ OKB-ja refuzoi të angazhohej më tej,²⁰⁹ që shënon fundin e perspektivave për mjete juridike përmes procesit të pretendimeve të palëve të treta.

PKDNJ vendos në favor të viktimave pavarësisht përpjekjeve ndaluese të UNMIK-ut

Pas hedhjes poshtë të ZÇL-së, grupi i banorëve të kampit i përfaqësuar nga Dianne Post kërkoi që PKDNJ të rihapte çështjen e tyre. PKDNJ-ja e mori përsëri çështjen dhe kërkoi angazhimin e UNMIK-ut në themel.²¹⁰ Ndërmjet qershorit 2012 dhe shtatorit 2014, PKDNJ vazhdimisht i kërkoi UNMIK-ut të komentojë themelin e ankesës në mënyrë që çështja të mund të vazhdojë.²¹¹ UNMIK-u nuk iu përgjigj ankesave të përsëritura të PKDNJ-së për të paraqitur komente mbi themelin e çështjes deri në dhjetor 2014, duke e shtyrë procedurën edhe për dy vjet të tjera.²¹²

Në shkurt 2016 - gati 10 vjet pasi banorët e kampit filluan të ndjekin veprime ligjore me OKB-në - PKDNJ-ja mori vendimin në favor të ankuesve.²¹³ Paneli e kritikoi ashpër UNMIK-un që nuk arriti t'i largonte në një vend tjetër familjet e zhvendosura, edhe pse ishte i vetëdijshëm për rreziqet shëndetësore ndaj të cilave ata ishin të ekspozuar. Ai konstatoi se “përmes veprimeve dhe mosveprimeve të tij, UNMIK-u ishte përgjegjës për komprometimin e pakthyeshmë të jetës, shëndetit dhe potencialit zhvillimor të ankuesve që lindën dhe u rritën si fëmijë në kampe.”²¹⁴ UNMIK-u kishte shkelur të drejtën e ankuesve për të drejtën e jetës, të drejtën për shëndet, të drejtën për të qenë të lirë nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruar dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.²¹⁵

Për më tepër, Paneli konstatoi se deklarata e OKB-së për PZHBV-të ishte prima facie e bazuar në paragjykimet racore.²¹⁶ Ata ishin të vetmit që u strehuan në kampet e kontaminuara dhe largimi i tyre u vonua nga rindërtimi jashtëzakonisht i ngadalshëm i Mëhallës së Romëve, në raport me rindërtimin në favor të komuniteteve të tjera të PZHBV-ve.²¹⁷ Paneli gjithashtu vërejti se UNMIK-u kishte dështuar në ofrimin e një arsyetimi objektiv dhe të arsyeshëm për këtë situatë, në vend të kësaj fajësoi mënyrën “e pashëndetshme” të jetesës së romëve -- justifikime që në vetvete ishin “të njollosura” nga paragjykimet racore.²¹⁸

Si rezultat i këtyre konstatimeve, PKDNJ-ja nxori një sërë rekomandimesh, ku përfshihen masat që duhen marrë nga UNMIK-u në mënyrë të menjëhershme:

- Të pranojë publikisht dhe t'u kërkojë falje viktimave dhe familjeve të tyre për dështimin për t'iu përmbajtur standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut si reagim ndaj gjendjes së pafavorshme shëndetësore të shkaktuar nga kontaminimi me plumb në kampet e PZHBV-ve dhe dëmit pasues të pësuar nga ankuesit;

- Të ofrojë kompensim adekuat për ankuesit për dëmet materiale dhe dëmet morale të pësuar;
- Të ndërmarrë hapat e duhur për të garantuar që organet e OKB-së që punojnë me refugjatët dhe PZHBV-të të promovojnë dhe tregojnë respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si garanci e mospërsëritjes.²¹⁹

Megjithatë, për shkak se PKDNJ është një organ këshillues, zbatimi i rekomandimeve të tij mbetet subjekt i diskrecionit të UNMIK-ut. Gjatë hartimit të këtij raporti, OKB-ja nuk zbatoi asnjë nga rekomandimet e PKDNJ-së.

IV. OKB-ja KA DËSHTUAR TË PËRMBUSHË REKOMANDIMIN E PKDNJ-së

Kur bëri betimin e tij si Sekretar i Përgjithshëm në dhjetor 2016, António Guterres u zotua se do të promovonte kulturën e llogaridhënies dhe se OKB-ja do të prioritzonte mjetet juridike të efektshme për viktimat e shkeljeve të kryera nën flamurin e OKB-së.²²⁰ Megjithatë, gjashtë vjet nga vendimi i PKDNJ-së, OKB-ja nuk ka arritur të zbatojë asnjë nga rekomandimet e PKDNJ-së. Kjo i privon viktimat e prekura nga e drejta e tyre për një mjet efektiv juridik, duke i bërë subjekt “të shkeljes së vazhdueshme të të drejtave të tyre njerëzore.”²²¹ Ai gjithashtu delegjitimon aftësinë e OKB-së për të mbrojtur të drejtat globale të njeriut dhe zeron premtimin e Sekretarit të Përgjithshëm Guterres për llogaridhënie dhe besueshmëri më të madhe të OKB-së.

A. Përgjigjja e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të PKDNJ-së

Si kryetar i UNMIK-ut, PSSP-ja ka autoritetin dhe diskrecionin për të vendosur nëse do të veprjë sipas konstatimeve të PKDNJ-së.²²² Në prill 2016, PSSP Zahir Tanin nxori një vendim në përgjigje të konstatimeve të PKDNJ-së.²²³ Ai shprehu “keqardhjen në lidhje me pasojat e pafavorshme shëndetësore të pësura nga ankuesit dhe familjet e tyre në kampet e PZHBV-ve”, por nuk mori përgjegjësi dhe nuk njoftoi veprime konkrete për zbatimin e rekomandimeve për mjete juridike.²²⁴ Kjo përgjigje nuk është aspak lloji i faljes publike të kërkuar nga PKDNJ-ja.

Për më tepër, ndërsa “duke mbajtur] parasysh rekomandimin e Panelit që të paguhet kompensimi”, PSSP-ja këmbënguli se çështja e kompensimit ishte “vlerësuar tashmë përmes procesit ekzistues të pretendimeve të palëve të treta të Kombeve të Bashkuara.”²²⁵ Ky pohim fals se vendimi i procesit të pretendimeve të palës së tretë ndalon veprimin mbi konstatimin e PKDNJ-së është i pabazë. Pas përpjekjeve të vazhdueshme për të kontrolluar rezultatin e çështjes duke e mbajtur çështjen brenda procesit të brendshëm të pretendimeve të palëve të treta, ZÇL-ja vërejti se çështja në fakt nuk kishte të bënte me të drejtën private dhe për këtë arsye binte jashtë juridiksionit të procesit të pretendimeve të palëve të treta.²²⁶ Ky vendim i pranueshmërisë nuk ka asnjë ndikim në detyrimin e veçuar të OKB-së për të ofruar kompensim për shkeljet e të drejtave të njeriut, të cilin OKB-ja e mandatoi në mënyrë specifike PKDNJ-në për ta përcaktuar.

[Ankimuesit në rastin e N.M.-së kundër UNMIK-ut] u viktimizuan dy herë nga UNMIK-u: një herë nëpërmjet dhunimit fillestar të të drejtave të njeriut kryer kundër tyre dhe një herë sepse shpresuan dhe besuan te ky proces.]

- Panelistët e HRAP-it, 2016

